



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 65 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullës Nr.19/2016, për Këshillat e Vendvotimeve, si dhe Vendimin e KQZ-së, nr.1661/2021, të datës 18.06.2021, për miratimin e Planit Operacional për Zgjedhjet Lokale 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të datës 21.10.2021 nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Shumës së Pagesave për Stafin e Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për Zgjedhjet e Lokale 2021.

1. Miratohet shuma e pagesave për stafin e angazhuar në Qendrat e Votimit (QVV) dhe në vendvotime (VV) për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 17 tetor 2021, dhe raundin e dytë të zgjedhjeve, si në vijim:
1. Njëzet e gjashtë EURO e pesëdhjetë cent (26.50)€ në ditë, çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit, Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
2. Njëzet e tri EURO e pesëdhjetë cent (23.50)€ në ditë, çdo Zëvendës Menaxheri të Qendrës së Votimit, Zëvendës Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
3. Katërdhjetë e pesë EURO (45.00)€ në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit, Kryesuesit e këshillit të vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
4. Tridhjetë EURO (30)€ në ditë, çdo Anëtari të Këshilli të Vendvotimit, Anëtarët e këshillave të vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
5. Tetëmbëdhjetë EURO (18)€ në ditë, çdo Zyrtari të Tavolinës Ndhimse në Qendër të Votimit, Zyrtarët e tavolinës ndihmese, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
6. Gjashtëmbëdhjetë EURO (16)€ në ditë, çdo Asistenti në Qendër të Votimit, Asistentët e QV-ve, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
7. Njëzet e dy EURO e pesëdhjetë cent (22.50)€ në ditë, çdo Anëtari Rezervë të Këshillit të Vendvotimit në Qendër të Votimit, Anëtarët rezervë të KVV-ve, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;

8. Pesëdhjetë EURO e pesëdhjetë cent (50.50)€ në ditë, çdo Pronari të kombibusit për transportimin e materialit jo të ndjeshëm dhe të ndjeshëm zgjedhor. Pronaret e kombibusëve, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
  9. Pesëmbëdhjetë EURO (15)€ në ditë, do të paguhet, çdo Punëtor fizik për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve zgjedhor në KKZ.
  10. Tridhjetë e tri EURO e pesëdhjetë cent (33.50)€ në ditë, çdo zyrtari të stafit K-VOTE, do të paguhet për periudhën kohore prej tri (3) ditësh.
- II. Pagesat për të gjitha kategoritë e sipër përmendura janë llogaritur në Bruto.
  - III. Obligohen Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve dhe anëtarët e KKZ-ve, që brenda pesë (5) ditëve nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi, t'i dorëzojnë listat e pagesave me saktësi në formë fizike (të nënshkruara) dhe elektronike në SKQZ.
  - IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
  - V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik

